




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.:	Nr. Prot.
Dep. <u>DPKI</u>	Pr. Prot. <u>06-01/3034/2</u>
Nr. i llog.	Data
Shprehja	Datum <u>26-07-2022</u>
Nr. pages	
<u>03</u>	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 22.07.2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti Nr. AKK-DPKI-06-2024/22, lidhur me vlerësimin e marrëveshjes së bashkëpunimit Nr. Prot.: 02-035/02-545, datë 17.05.2022, të lidhur në mes Komunës së Vitisë dhe Kolegjit UBT, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshem për ekzistimin e konfliktit të interesit.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë, nëse paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt të interesit lidhur me një marrëveshje bashkëpunimi të lidhur në mes Komunës së Vitisë dhe Kolegjit UBT, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Ky rast ka filluar të trajtohet sipas kërkesës së parashtruar në formë të shkruar nga një palë e jashtme (në tekstin e mëtejme: raportues i rastit), përveç tjerash, edhe me pretendimin për konflikt të interesit, citoj: *“për faktin që pas hartimit të Hartës Zonale dokumenti në fjalë duhet të shkoj për aprovim në Ministri të Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës (MMPH), pra do të shkoj tek ministria që udhëheqë z. Liburn Aliu, i cili merr pagë nga Kolegji UBT [...] dhe do të vendosë për aprovim ose jo për Hartën Zonale e cila del nga marrëveshja ku negociator ka qenë këshilltari i tij”*. Pra, në kërkesë thuhet gjithashtu se, citoj: *“Në këtë marrëveshje si pjesë e negociatave shihet edhe z. S.H.A., i cili brenda UBT-së ka pozitën e Drejtorit të Institutit për studime urbanistike dhe planifikim hapësinorë, ndërsa sipas CV-së së tij, i njëjti që nga prilli i vitit 2021 është këshilltar i ministrit të MMPH”*.

Përveç njoftimit (dokumentacionit) fillestar, raportuesi i rastit ka deponuar edhe dokumentacion plotësues, ndërsa me qëllim të sqarimit të plotë të këtij rasti, Agjencia kundër Korrupsionit ka kërkuar dhe mbledhur informacion dhe dokumentacion relevant nga institucionet përkatëse (shkresat zyrtare: DPKI-06-01/2162-1/22, DPKI-06-01/2163-1/22, DPKI-06-01/2164-1/22).

Pas trajtimit të të gjithë informacionit dhe dokumentacionit në dispozicion, Agjencia kundër Korrupsionit ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

- Bazuar në përgjigjen e Ministrit të MMPHI-së, Nr. Prot.:3063-2/22, dt. 03.06.22, z. Sh. A. nuk ka kontratë/akt të emërimit në MMPHI, gjegjësisht nuk është i punësuar në kabinetin e Ministrit Aliu.
- Sipas kontratës nr. 1276/43-01, dt.1901.2022, z. SH.A. ka të themeluar marrëdhënie pune me Kolegjin UBT për periudhë kohore prej 05.01.2022 deri më 31.12.2022, si Koordinator i qendrës për planifikim urban.
- Në përgjigje të zyrës ligjore të Komunës së Vitisë në kërkesën e Agjencisë kundër Korrupsionit, thuhet se: *Komuna e Vitisë në bazë të dispozitave ligjore ka propozuar këtë marrëveshje për aprovim në Kuvendin Komunal të Komunës së Vitisë, e njëjta ka kaluar në Kuvend me datë 27.05.2022 dhe ka shkuar për aprovim në Mistrinë përgjegjëse për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë.*
- Në shkresën e Drejtorisë së Departamentit ligjor të MMPHI-së theksohet se, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit 01-110/05-546 për miratimin e draft marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Vitisë dhe Kolegjit UBT, miratuar nga KK Viti, dhe në pajtim me nenin 4 të Rregullores (QKR) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunës, konstatoi: se MMPHI nuk është kompetente për shqyrtimin e këtij akti komunal, pasi që dispozitat ligjore të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe akteve nënligjore në fuqi, nuk e parashohin një marrëveshje të tillë.

Konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me vendimmarrjen, ndërsa lidhur me pretendimet e ngritura nga raportuesi i rastit për konflikt të interesit që ndërlidhin z. SH.A., i njëjti nuk rezulton të ketë qenë pjesë e ndonjë vendimmarrje në rastin në fjalë dhe nuk është pjesë e MMPHI-së.


Ndërsa sa i përket ndërlidhjes së rastit me MMPHI-në, e njëjta, në mungesë kompetence nuk e ka shqyrtuar fare aktin - vendimin 01-110/05-546 për miratimin e draft marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Vitisë dhe Kolegjit UBT, miratuar nga KK Viti.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, Agjencia kundër Korrupsionit vlerëson se në rastin konkret nuk janë gjetur prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, andaj u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Yll Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

